



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

ZSP- Nr. 6/2026

Datë: 09/01/2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare Nr.7/01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 65 paragrafit 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik si dhe paragrafit 4 të nenit 11 të Rregullores nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Sekretarja e Përgjithshme nxjerr:

V E N D I M

për transferimin e përhershëm të nëpunësve civile për interes të institucionit

1. Znj. Anesa Sllovinja, nga pozita aktuale “Zyrtare e Lartë Ekzekutive” në Zyrën e Sekretares së Përgjithshme, transferohet përhershëm brenda të njëjtës kategori të shërbimit civil për interes të institucionit në pozitën: “Zyrtare e Lartë Ligjore” në Divizionin për Legjislacionin e Fushës Civile dhe Administrative në Departamentin Ligjor.
2. Obligohet Njësia për Burime Njerëzore dhe Njësia për Buxhet dhe Financa që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi dhe pagesën e nëpunësve sipas pagës së pozitës në të cilën është transferuar.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në zbatim të Rregullores ZKM-Nr.10/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Drejtësisë, për shkak të domosdoshmërisë së plotësimit të pozitës dhe në interes të institucionit, është parashtruar kërkesa më datë 09.01.2026 për transferimin e përhershëm të nëpunësve civile Anesa Sllovinja, brenda kategorisë së njëjtë profesionale nga pozita “Zyrtare e Lartë Ekzekutive” në Zyrën e Sekretares së Përgjithshme, në pozitën “Zyrtare e Lartë Ligjore” në Divizionin për Legjislacionin e Fushës Civile dhe Administrative në Departamentin Ligjor.

Në mbështetje të nenit 65 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 11 të Rregullores nr.02/2024 për transferimin e nëpunësve civil, duke u bazuar në kërkesën e arsyetuar për këtë transferim, dhe pas marrjes së pëlqimit nga nëpunësja civile, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi i'u dërgohet:

- *Znj. Anesa Sllovinja;*
- *Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Departamentit për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*